

**RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMIT TË
NDIKIMIT NË MJEDIS
EMËRTIMI I PROJEKTIT:
OBJEKT SHERBIMESH - ZYRA MAGAZINE DHE
PARK AUTOMJETESH**

(Emertimi Sipas ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011, "Për VNM", Shtojca 2, pika 10 Prodhime
infrastrukturore)

Subjekti "CAGATAY LOGISTICS ALBANIA" Sh.p.k

Vendndodhja: RRUGA MUCAJ DHE HASARAMA FSHATI MUCAJ –BASHKIA VORE

Hartoi: Ky raport parapraek i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga eksperti XHEVAJRI DERMYSHE Me
numercertifikate 331 Prot Vendimi Nr 11, Nr 086 Regj. Nr License LN 00042-06. "STUDIO PROJEKT
SH.P.K K620210015"

Tirane, 2016

**RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMIT TË
NDIKIMIT NË MJEDIS
EMËRTIMI I PROJEKTIT:
OBJEKT SHERBIMESH - ZYRA MAGAZINE DHE
PARK AUTOMJETESH**

(Emertimi Sipas ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011, “Për VNM”, Shtojca 2, pika 10 Prodhime
infrastrukturore)

Subjekti : “CAGATAY LOGISTICS ALBANIA ” Sh.p.k

Vendndodhja: RRUGA MUCAJ DHE HASARAMA FSHATI MUCAJ –BASHKIA VORE

Hartoi: Ky raport paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga eksperti: XHEVAIR
DERMYSHI Me numer certifikate 331Prot Vendimi Nr 11,Nr 086 Regj.Nr License LN 00042-06-
“STUDIOPROJEKT SH.P.K K62021001S”

Tirane, 2016

PERMBAJTJA

- STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN RAPORTI PARAPRAK I VNM
- HYRJE
- INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

A. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.

B. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ

C. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Ç. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

D. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE

DH. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

E. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Ë. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

F. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË)

SHPJEGIMI I AKRONIMEVE

- **“Cilësi e mjedisit”** është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.
- **“Dëmtim i mjedisit”** është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.
- **“Kapacitet bartës”** është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, vetitë e tij natyrore.
- **“Mjedis”** janë përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.
- **“Mjedis i kërcënuar”** është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnisë së një ndotjeje të konsiderueshme.
- **“Ndërhyrje negative në mjedis”** është çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut, që mund të prekë kapacitetin bartës të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose që ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin.
- **“Ndotje”** është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit.
- **“Subjekt ndotës ose ndotës”** është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit.
- **“Substancë e rrezikshme”** është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t’u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.

- **“Shkarkim”** është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.
- **“Gjendje e pranueshme e mjedisit”** është gjendja në të cilën mjedisi i vendit në fjalë ishte para se instalimi të vihej në operim. Arritja e kësaj gjendjeje kërkon masa që përfshijnë, por nuk kufizohen me: largimin e të gjitha mbetjeve që kanë tepruar, largimin sa më shumë të jetë e mundur të çdo lloj ndotjeje, dhe, aty ku ky largim nuk do të thotë trajtim praktik apo stabilizim i ndotjes, rehabilitimin e çdo dëmi që mund të ketë shkaktuar ndotja, si dhe zbutjen e efekteve të çdo dëmi.
- **“Instalim”** është çdo njësi teknike e palëvizshme, që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie që lidhet drejtpërdrejt me të apo ka një lidhje teknike me veprimtaritë e zhvilluara në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;
- **“Instalim ekzistues”** është: a) një instalim që është në funksionim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) një instalim që nuk është vënë ende në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi, por për të cilin është dhënë leja e ndërtimit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 119 datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, dhe ndërtimi i të cilit fillon brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- **“Instalim i ri”** është: a) një instalim që nuk është instalim ekzistues; b) një instalim ekzistues, për funksionimin e të cilit operatori nuk ka kërkuar pajisjen me lejen përkatëse të mjedisit, brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj. Në këtë rast, ky instalim trajtohet si një instalim i ri.
- **“Normat e cilësisë së mjedisit”** është një grup kushtesh që duhen përmbushur në një kohë të dhënë nga një mjedis i caktuar ose një pjesë e veçantë e tij, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- **“Substancë”** është çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive dhe të organizmave të modifikuar gjenetikisht, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- **“Shkarkim në ujë”** janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të zeza e të bardha.
- **“Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)”** është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të

përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundshme, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.

- **“Biomasaë”** është produkt i përbërë, tërësisht ose pjesërisht, nga material bimor nga bujqësia ose pemëtaria, që mund të përdoret si lëndë djegëse, me qëllim rikuperimin e energjisë së përmbajtur në të.
- **“Vlera kufi e shkarkimit”** është sasia e lejueshme e një substance në masën e gaztë të shkarkuar në ajër nga instalimi me djegie, gjatë një periudhe të dhënë. Sasia e substancës llogaritet në terma të masës/për vëllim të gazeve të shkarkuara, të shprehura në mg/Nm³, duke konsideruar një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara: prej 3 për qind, në rastin e karburanteve të lëngshme e të gazta, 6 për qind në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 për qind në rastin e turbinave me gaz.
- **“Projekt” është:**
 - zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;
 - ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve.
- **“Zhvillues”** është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik.
- **“Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)”** është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.
- **“Publiku”** ka kuptimin që jepet në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- **“Publik i ndikuar”** është publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore që shprehin interes.
- **“Vendim”** është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin është vendosur nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo t’i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.
- **“Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis”,** më poshtë “Deklarata mjedisore”, është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri, për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar dhe që përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës që i bashkëlidhet ligjit Nr. 10 081, date 23.2.2009 “Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë”.

- **“Vlerësim ndërkufitar i ndikimeve në mjedis”** është procesi i VNM-së, që zhvillohet për projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara (ESPOO) “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar”, që, bazuar nga vendndodhja a teknologjia e tyre, mund të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e shteteve fqinje apo të vendit tonë.
- **“Ekspert i certifikuar i VNM-së”** është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor

HYRJE

Ndertimi është një ndër sektoret më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Tranzicioni ekonomik dhe politik i ka dhënë një zhvillim të fuqishëm këtij sektori dhe e ka transformuar Shqipërinë në një kampion të madh. Përsa i përket cilësisë së punimeve dhe strukturave janë verifikuar ndryshime të vazhdueshme. Deri në fillimin e viteve '90, rreth 95% e ndertimit të banesave ishte i nivelit të mesëm e të ulët. Nga viti 1998 e deri më sot, sektori i ndertimit, si rezultat i rregullave të reja të ndertimit dhe cilësisë së materialeve të përdorura, ka arritur një nivel të mesëm. Tendencat e stoshme të projektimit për banesa, kanë prirjen të shkojnë drejt pallateve me më shumë se dhjetë kate ndërkohe që çmimi i tokës është rritur shumë.

Zhvillimi i pakontrolluar urban, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë, përdorimi i burimeve natyrore në mënyrë jo të qëndrueshme dhe mungesa e stimuljeve ekonomike për ruajtjen, zhvillimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, ndotja historike e trashëguar, mungesa e praktikave të mira të menaxhimit dhe kontrollit të shkarkimeve në mjedis, shkalla e ulët e ndergjegjesimit mjedisor të publikut dhe biznesit për problemet e mjedisit, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë rënduar gjendjen e mjedisit. Lëvizjet e mëdha demografike që kanë shoqëruar zhvillimet në dy dekadat e fundit kanë ndikuar ndjeshëm në jetën social-ekonomike të popullsisë. Shumë zona me parpara të pa njohura, sot janë populluar nga migracioni i banorëve të zonave më të thella të vendit drejt zonave me perspektive më të mira zhvillimi.

Keto levizje demografike jane shoqeruar me nje rritje dramatike te numrit te aktiviteve te ndertimit. Nje numur i madh ndertimesh jane kryer ne menyre informale dhe pa lejet e nevojshme . Projekti i propozuar nga investitori, ka per qellim, ndertimin e nje strukture me funksion zyra qendrore magazine dhe park automjetesh . Ky raport do te jape nje vleresim te pergjithshem te ndikimeve qe do te kete ne komponentet perberes te mjedisit, ndertimi i ketij objekti , mbi bazen e projektit te hartuar , duke parashikuar masa dhe veprime per te parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis ne fazen e ndertimit

➤ **INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR**

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor per VNM dhe ka per qellim qe te parashikojë, identifikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin ne mjedis te projektit te propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

➤ **OBJEKTIVI I RAPORTIT**

Objektivat afatgjate te VNM jane

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimitet e pakthyeshme te mjedisit;
- Ndikon ne mbrojtjene burimeve natyrore, paisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit
- Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efçence;
- Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit.
- Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te Disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit te propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, nepermjet harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit. Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi , si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi, dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit. Ky raport i VNM e pajis shoqerine me nje instrument menaxherial per te zbatuar ne kryerjen e punimeve te parashikuara , te gjitha kerkesat ndaj mjedisit per te minimizuar ndikimet mbetese ne mjedis, individe dhe ne komunitet ne zonen ku do te kryehet ndertimit. Ky raport paraqet nje pershkrim te projektit, gjendjen egzistuese te mjedisit dhe jep nje vleresim te ndikimit. Ne perfundim te projektit do te behet vleresimi i pajtueshmerise me Planin e Menxhimit Mjedisor (PMM) e nese do te jete e nevojshme per vleresime shtese dhe veprime te metejshme per zvogelimin e ndikimit.

PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR TË KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL QË LIDHET ME PROJEKTIN

Legjislacioni per planifikimin e territorit

Ligji per Planifikimin e Territorit synon: zhvillimin e qendrueshem, ekonomik e social, i cili, ne baze te nje metodologjie, qe perfshin studime dhe parashikime sociale, kulturore e ekonomike, percakton vizionin per zhvillimin e ardhshem te territorit, duke marre parasysh alternativat e zhvillimit strategjik, garanton brezat e sotem e ato te ardhshem per cilesi te larte te mjedisit, zhvillim ekonomik te balancuar dhe te harmonizuar, kohezion ekonomik e social, perdorim racional te burimeve natyrore, njerezore e materiale, zhvillimin dhe ruajtjen e trashegimise natyrore dhe kulturore

Ligji per Planifikimin e Territorit, ka si qellim :

- a. te siguroje zhvillimin e qendrueshem te territorit, nepermjet perdorimit racional te tokes dhe te burimeve natyrore;
- b. te vleresoje potencialin aktual e perspektiv per zhvillim te territorit ne nivel kombetar e vendor , ne baze te balancimit te burimeve natyrore , te nevojave ekonomike e njerezore dhe interesave publike e private, duke bashkerenduar :
- c. mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka , ne vec;:anti toka bujqesore , ajri, uji , pyjet, flora, fauna, peizazhet dhe midis te tjerash
- d. te mundesoje te drejten e perdorimit e te zhvillimit te prones, ne perputhje me instrumentet planifikuese dhe ligjet mjedisore.

- Ligji Nr. 107/2014, "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"
- Ligji Nr. 50/2014 "Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje i ndyshuar"
- VKM Nr.459, date 16.6.2010 per "Miratimin e standardeve te perbashketa gjeodezike dhe gis."
- VKM Nr.460, date 16.6.2010 per "Organizimin dhe funksionimin e regjistrimit te planifikimit te territorit."
- VKM Nr.480, date 22.06.2011 per "Miratimin e rregullores model te planifikimit.

- VKM Nr.481, date 22.06.2011 per "Miratimin e rregullores uniforme te instrumenteve te planifikimit."
- VKM Nr.502, date 13.07.2011 per "Miratimin e rregullores te kontrollit te zhvillimit te territorit"

➤ **LEGJISLACIONI MJEDISOR**

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve te veçante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore ne lidhje me kete projekt, mund te permendim:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”.
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”.
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.
- Vendim Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendim-marrjen mjedisore”.
- Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave.

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky aktivitet, nuk perfshihet ne listat e aktiviteve te cilat duhet te pajisen me leje mjedisore te tipit A, B ose C, as me Vendim per VNM paraprake, por ky raport hartohet bazuar ne kerkesat e institucioneve te tjera per raport te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per paisje me Leje Zhvillimore te objekteve te reja qe ndertohen, ose per legalizimin e objekteve informale. Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet kryesisht per fazen e kryerjes se punimeve te ndertimit te objektit, pasi gjate fazes funksionale, nuk vleresohet me ndikim ne mjedis, megjithate permenden edhe pikat kryesore te ndikimit ne mjedis gjate funksionimit.

PROCEDURA E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Kreu II, Neni 7, i Ligjit Nr.10440, date 07.07.2011 ndyshuar me ligjin nr.12/2015 percakton;

1. Projektet private apo publike, te listuara ne shtojcat I dhe 11, bashkelidhur ketij ligji, i nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis, ne perputhje me kerkesat e kreut II te ketij ligji, perpara dhenies se lejes perkatese nga autoriteti pergjegjes per zhvillimin ose jo te projektit.
2. Procedura e vleresimit te ndikimit ne mjedis perfshin:
 - a) procesin paraprak te vleresimit te ndikimit ne mjedis;
 - b) procesin e thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis.
3. Dokumenti baze ku mbeshitetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili, ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit, mund te jete:
 - a) raporti paraprak i VNM-se per projektet e shtojces 11;
 - b) raporti i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I.

Referuar Shtojces 2 te ligjit per VNM-en kemi:

Projektet qe i nenshtrohen procedures paraprakete Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Pika 3. Prodhime infrastrukturore

a) Projekte per zhvillimin e pasurive te patundshme industriale

Pra, ky projekt i ndertimit duhet t'i nenshtrohet procedures paraprake te VNM-se VKM Nr.686, date 29.07 .2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore", percakton proceduren qe po ndiqet.

Tarifa e sherbimit

Referuar Udhezimit Nr.7938, date 17.07.2014 te Ministrit te Mjedisit dhe Nr.10442/ 1, date 31.07.2014 te Ministrit te Financave, tarifa perkatese e sherbimit per shqyrtimin e kerkese per procesin e Vleresimit Paraprak te Ndikimit ne Mjedis eshte 30.000 Leke.Kjo tarife do te paguhet ne llogari te Ministrise se Mjedisit nepermjet pagese se fatures per arketim.

a) Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shogeruar dhe me fotografi.

- **Mbulimi i tokes dhe qellimi i saj**

Zona eshte ne pergjithesi e mbulur nga barishte. Zona ne vleresim vleresohet si toke e llojit are ku sot nuk eshte e shfrytëzuar per qellime bujqesore apo blektorale, eshte nje siperfaqe toke industriale me pamje te thjeshte dhe me pamje nga rruga internacionale.

Objekti ndodhet ne Fshatin Mucaj –Bashkia Vore

- **Peisazhi, topografia dhe mbulesa e tokes**

Qyteti i Tiranës shtrihet në Perëndim të malit të Dajtit dhe rrethohet nga lindja, Jug dhe Perëndimi prej kodrave të perbera kryesisht prej depozitimeve ranorike të perziera me argjila të Miocenit të Siperit. Ndërsa në Veri shtrihen kodrat e buta të Babruse, që ndahen nga qyteti nëpërmjet shtratit të lumit të Tiranës. Pjesa kryesore e qytetit shtrihet mbi depozitimet e mira të terraces së dytë të lumit të Tiranës, të perbera kryesisht prej argjilash të kuqe.

Ngjitur me këto terraces, në pjesën Jugore të saj shtrihet terraca e parë e lumit Lana, që përbehet kryesisht prej argjilave të verdha me veti bufatese. Terracat e para të lumit të Tiranës dhe të Lanës, bashkohen në pjesën perëndimore të qytetit, duke krijuar kështu ish-zonën kenetore të Yzberishtit, ku mbizoterojnë kryesisht troje të dobët ose shumë të dobët si surera, suargjila, lymra dhe torte. Territori në studim karakterizohet nga një ultësirë me një shtrirje pas a shumë horizontale, me kuota në kufijtë 40-45m mbi nivelin e detit, Terreni i zonës është fushor dhe pa pjerrësi. Territori ka një peisazh të thjeshtë tipike të një zone rurale dhe të shfrytëzuar si zonë

- **Pozita gjeografike**

Qarku i Tiranës shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë, duke zënë një pjesë të Ultesirës Bregdetare dhe asaj të Kavajës, viset kodrinore përreth tyre dhe Malesinë e Tiranës. Ai kufizohet nga Qarku i Durrësit në Veri-Perëndim, (përkatesisht rrethet Krujë e Durrës), me Qarkun e Dibërës në Veri e Verilindje (përkatesisht rrethet Mat e Bulqizës), me Qarkun Elbasan në Lindje e Juglindje, me Qarkun e Fierit në Jug dhe me detin Adriatik në Perëndim (rrethi i Kavajës). Ky Qark shtrihet në një zonë gjeografike shumë interesante dhe një natyrë ku lehtësisht identifikohen diversiteti dhe potencialet e shumta turistike.

Gjendet në kryqezimin e rrugëve të rëndësishme tokësore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, në një fushë të gjere pjellore, të rrethuar me kodra dhe male të veshura me pyje, me pasuri të shumta hidrike, klime të pershtatshme për zhvillimin bujqësor dhe atë urban, me dalje në det dhe burime të shumta turistike. Relievi është i shumëllojshëm, si për sa i përket lartësive, ashtu edhe formave të tij. Shtrihet nga niveli i detit e deri në lartësinë 1848 m (maja e Senoit të Madh, i cili kufizohet me rrugën e Bulqizës).

Pra relieve i Qarkut Tirane perbehet nga te gjitha format e tij si: bregdeti, tushat, luginat, kodrat dhe malet. Vija bregdetare percaktohet nga prania e Detit Adriatik ne zonen e Kavajes, me nje shtrirje prej 33 km dhe me nje plazh te mrekullueshem, ku nderthuren flora dhe fauna e pasur mesdhetare. Ajo formohet nga renia mjaft e pjerrret e kodrave te Kryevidhit ne Perendim te qytetit te Kavajes. Kjo eshte nje riviere e vogel, por me vlera te pasura turistike. Nje pjese e saj eshte e ulet me plazhe te gjera ranore (plazhi i Spillese) ne bregun e djathte te grykes se Shkumbinit, plazhi i Karpenit ne Jug te Gjirit te Duresit etj.

Fushat kryesore jane ajo e Tiranës (pjese e Fushes se Arbrit) dhe ajo e Kavajes. Fusha e Tiranës shtrihet ne drejtim te veriut deri ne Kamez, ne drejtim te Jugut deri ne rrjedhen e lumit Erzen, ne drejtim te perendimit deri ne vijen Vore – Yzberish dhe ne drejtim te Lindjes, deri ne vijen Babru-Zall Herr-Qinam, ku fillon e ngrihet mali i Dajtit. Lartesia e tushes varion 25 – 30 m ne Perendim, ne 100-150 m ne Lindje, derisa njehsohet me kodrat perreth. Pikerisht ne skajin Linder te tushes se Tiranës, gjendet edhe qyteti i Tiranës. Fusha e Kavajes (ndryshe Myzeqeja e Kavajes) shtrihet nga rrjedha e poshtme e Shkumbinit ne Jug e deri tek Mali i Robit ne Veri. Ndodhet pikerisht mes kodrave te Kavajes ne Lindje dhe atyre te Kryevidhit ne Perendim.

Pjese e tushes se Kavajes eshte edhe ajo e Spillese. Luginat kryesore te Qarkut Tirane jane ajo e Erzenit ne lumin e Tiranës dhe Lumit te Terkuzes. Keto e kane fillesen nga Malesia e Tiranës dhe pasi 9ajne terthorazi vargmalin Kruje – Dajt, ku formohen edhe disa gryka dhe kanione disa qindra metra te thella, perfundojne ne tushen e Tiranës, ku lugina pothuajse zhduket dhe merr pamjen e tushes. Kodrat zene nje siperfaqe te madhe, sidomos ne periteri te tushave, ku formojne grumbuj e madje bloqe te tera kodrinore me relief te ulet. (50m-200m). Qyteti i Tiranës eshte i rrethuar pothuajse i teri nga vargjet kodrinore si ato te Ibe-Linez-Vaqarr-Sharre-Arbane, Sauk-Lunderetj.

Zona me e larte kodrinore eshte ajo e Krrabes qe pjeserisht i taken rrethit te Elbasanit. Ne zonen kodrinore te Tiranës ben pjese edhe ajo qe quhet Rreza e Dajtit, e cila shtrihet ne rrezen perendimore te malit te Dajtit, nga gryka e Skoranes ne Juglindje, aty ku del lumi Erzen. Fshatrat kryesore te kesaj rrethine jane: Gurra, Brari, Priska e Madhe, Lanabregasi, Linza, Tujani, Zall- Herri, Priska e Vogel, Selita e Vogel etj. Ne rrethin e Kavajes, kodrat kryesore jane ato te Kryevidhit ne Perendim. Malet zene pothuajse te gjithe pjesen lindore te qarkut.

Ne pjesen lindore te zones tushore-kodrinore shtrihet ne drejtimin Veri-Juglindje vargmali i Bjesh- Dajt-Mali i Priskes-Mali i Peshkasheshit. Nje veqori tjetër e malit te Dajtit jane qatat dhe grykat lumore qe 9ajne terthor malin ne qindra metra thellesi dhe disa kilometra gjatesi, duke krijuar kanione madheshtore me bukuri mahnitese. Ketu mund te permendim gryken e Skoranes e cila 9ahet nga Erzeni ,gryka e lumit te Tiranës midis Zall-Dajtit dhe fshatit Brar, gryka e lumit te Terkuzes nga Zall-Bastari ne Zall-Herr etj. Mali me Gropa shtrihet ne Lindje te Dajtit. Karakteristike per kete mal jane perhapja shume e madhe e proceseve dhe formave karstike te reliefit, ve9anerisht gropave, hinkave, gerxheve etj.

Rrethi i Tiranës eshte i kufizuar:

- nga jugu me rrethin e Peqinit,
- nga juglindja me rrethin e Elbasanit,
- nga verilindja me rrethin e Bulqizes,
- nga verilindja e veriu me rrethin e Matit,
- nga veriu e pjeserisht nga veriperendimi me rrethin e Krujes,
- nga perendimi me rrethin e Durrësit dhe se fundi,
- nga jugperendimi me rrethin e Kavajes

Rrethi i Tiranës eshte ndertuar mbi nje tarrace aluvionale, ndodhur midis ultesires se lumit te Tiranës dhe planit te pare te sistemit kodrinor te Kerrabes. Kjo eshte nje fushe e gjere, pjese e hapesires me te madhe qe mban emrin e treves se Tiranës. Fusha e Tiranës se bashku me fushat e tjera te Krujes e te Lezhes, formojne pjesen Veriore te Ultesires Perendimore . Pjesa fushore e qytetit ze 37% te siperfaqes dhe lartesia mesatare e qytetit arrin ne 110m. Kjo fushe ose "tarrace" ka nje pjerrsi te lehte me renie ne drejtimin Veri-Perendimor drejt detit, 9ka lejon dhe derdhjen e ujerave te lumenjve ne te.

Ne anet e tjera ndodhen kodrinat (e Saukut, Kerrabes e Vaqarit) , te cilat formojne nje kurore, perkatesisht ne skajet Perendimore , lindore dhe Jugore te qytetit qe arrijne 120 e 130 metra lartesi. Qarku i Tiranës dhe qyteti i Tiranës si kryeqytet i Shqiperise kane pesuar ndryshime te konsiderueshme gjate 15 viteve te fundit. Levizja e popullates si brenda vendit dhe jashte tij kane sherbyer si strategji mbijetese per banoret e vendit. Shume banore e kane lene Tiranen , por shume me teper kane levizur nga pjeset e tjera te vendit. Tirane ka ofruar

zgjdhje per shumicen e shqiptareve qe kane zgjedhur te jetojne ne Shqiperi. Fillimisht shume familje u zhvendosen ne drejtim te Tiranës per ti shpetuar izolimit provincial dhe varferise.

Sot shume te tjere zhvendosen drejt Tiranës per te zhvilluar bizneset e tyre, jete me te mire dhe arsimimin e femijve. Tirana eshte bere qyteti i larmise kulturore, nderimeve te shpejta dhe rritjes ekonomike . Qarku ka nje popullsi rreth 1 milion banore, perfshire banoret e perhershem dhe punetoret seziona le. Permirsimet ne infrastrukture, tregti , administrate , arsimim dhe mbrojtjen e mjedisit jane te nevojshme. Tirana ballafaqohet sot me kerkesat per te siguruar jetese me te mire per banoret e saj, dhe kushte me te mira per rritje te vazhdueshme ekonomike. Fshatrat pergjate rrugeve kryesore po kthehen ne qyteza nga rritja e shpejte industriale. Qarku i Tiranës i cili ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 1 652 km² permban dy rrethe, ate te Tiranës dhe te Kavajës. Zona Gjeografike: Bashkia e re e Vares shtrihet ne Shqiperine qendrore dhe kufizohet ne veri me bashkine Kruje, ne lindje me bashkine Kamez, ne jug me bashkine Tirane, ne jug-perendim me bashkine Shjake dhe ne lindje me bashkine Durres.

Informacion i pergjithshem mbi Zonat e Mbrojtura

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarit e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbështetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u

krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

BASHKIA VORE

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Vore ka 25,511 banorë ndërsa sipas Regjistrimit Civil ka 36,230 banorë. Me një sipërfaqe prej 82.72 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të censurit është 308 banorë/km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 438 banorë/km². Bashkia e re përbëhet nga tre njësi administrative të cilat janë Vore, Preze dhe Bërxulle. Në këtë bashki ka një qytet dhe 18 fshatra. Të gjitha janë njësi përbërëse të rrethit të Tiranës, qarku i Tiranës.

Pozita gjeografike

Bashkia e re e Vores shtrihet në kryqezimin kryesor rrugor të Shqipërisë ku lidhet Tiranë me Durrësin dhe veriun me jugun e vendit. Për rrjedhojë, në territorin e kësaj bashkie janë vendosur një pjesë e rëndësishme e industrisë së lehtë dhe të ndërtimit ndërsa bujqësia është përqendruar në disa produkte me vlerë të lartë të shtuar si lulet. Në Bashkinë e Vores janë të regjistruara mbi 800 biznese të mëdha. Në ish-komunën Preze gjendet një kala mesjetare e cila përbën në resurs të vogël turistik. Vora dhe tri njësitë përbërëse kanë parë rritje të shpejtë të popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit, gjë që ka sjellë edhe një numër të konsiderueshëm ndërtimesh jashtë planeve urbanistike dhe pa infrastrukturë.

Vora, si njësi fiziko-gjeografike, bën pjesë në rajonin perëndimor të Shqipërisë dhe shtrihet në vargun kodrinor-fushor "Rodon-Vore-Krrabe". Është njëja lidhëse kryesore që lidh veriun e Shqipërisë me jugun. Ka reliev kodrinor-fushor me shtrirje gjeografike 12.5 km veri-jug dhe 6.2 km në drejtimin lindje-perëndim. Ndodhet 7 km nga aeroporti i vetëm kombëtar, ai

i Rinasit , 16 km nga kryeqyteti i Shqiperise, Tirana dhe 20 km nga porti i Durresit. Perfshihet ne prefekturen e Tiranes, e cila eshte e pozicionuar ne gjeresine gjeografike: veri 41030'56";jug41007'10";gjatesi gjeografike: lindje 20013'29", perendim -19035'32".

Bashkia Vore kufizohet nga keto njesi vendore:

- Ne jug me komunen e Ndroqit (Tirane)
- Ne juglindje me komunen e Kasharit (Tirane)
- Ne lindje me komunen e Berxullit (Tirane)
- Ne verilindje me komunen e Prezes (Tirane)
- Ne perendim me komunen e Maminasit dhe Manzes (Durres)

Ne kete aspekt bashkia e Veres shihet ne 2 kendveshtrime. Kendveshtrimi i pare eshte lehtesia qe ofron pozita gjeografike e favorshme, ku Vora paraqitet si nje nyje lidhese ndermjet aeroportit te vetem kombetar , portit te Durresit si dhe kryeqytetit te vendit. Per kete arsye bizneset kane lehtesi ne tregtimin, qarkullimin e produkteve te tyre ne tregjet kombetare dhe nderkombeta re.Ne Kendveshtrimin e dyte Vora gjen nje promovim nepermjet sherbimit cilesor qe ofrohet nga administrata tatimore e bashkise ne drejtim te zhvillimit te metjeshem dhe nxitjes se biznesit, sherbim qe mbeshtet ne parimet themelore si parimi i ligjshmerise, barazise, transparences, pergjegjshmerise , panshmerise etj.

Zhvillimi i metejshem do te percaktohet dhe orinetohet me drejte nepermjet hartimit dhe implementimit te masterplanit te te gjitha zones, krijimit te lehtesirave per bizneset ekzistues dhe atyre te reja, permiresim te metejshem te klimes per terheqjen e investimeve shqiptare dhe te huaja si dhe kualifikim te gjenerates se re per te qene e afte te integrohet sa me mire ne tregun e punes, dhe te aftesohet ne shfrytezimin e teknologjive ekzistuese dhe atyre te pritshme.

Ne territorin e bashkise Vore ushtrojne aktivitetin 749 biznese. Nga ku:

- 297 biznes i madh
- 452 biznes i vogel.

Ky numer i madh biznesi tregon per nje ambjent te sigurt per kryerjen e investimeve apo ushtrimin e veprimtarive te ndryshme ekonomike ne hapesiren administrative te bashkise

Peisazhi, topografia dhe mbulesa e tokes

Dheu i germuar nga sheshi, per shkak te perqendrimit te larte te Cr dhe Ni duhet te hiqet dhe te depozitohet ne nje vend i cili do te miratohet se bashku me Ministrine e Mjedisit dhe autoritetet ne Bashki. Perpara largimit te dheut te germuar, sheshi duhet te vizitohet edhe nga konsulenti mjedisor i i cili do te informoje MM ne lidhje me zgjedhjen, duke dhene nje justifikim te shkurter per sheshin. Administrimi i mbetjeve gjate fazes se ndertimit duhet te behet ne perputhje me kerkesat dhe rregullat e vendosur autoritetet lokale . Te sunohet riperdorimi i mbetjeve te ngurta, por edhe kur kjo nuk eshte e mundur depozitimi i tyre te behet me leje te institucioneve perkatese dhe ne vendin e caktuar per kete qellim.

- **Zbulimet arkeologjike rastesore**

Nuk ka zona te rendesishme arkeologjike ne afersi te sheshit, prandaj nuk kerkohen masa te vecanta mbrojtese arkeologjike. Megjithate, nese gjate germimeve zbulohen disa mbetje arkeologjike, punimet do te nderpriten menjehere dhe do te informohet autoriteti lokal competent. Punimet do te rifillojne vetem pasi te jene marre masat e duhura, te kerkuara nga autoriteti perkates dhe te jete marre konfirmimi qe punimet mund te vazhdojne.

Zonat e ndjesme mjedisore dhe ndikimi nderkufitar

Zona ne vleresim nuk klasifikohet ne listen e zonave me status te vecante, eshtre nje zone e zakonshme urbane. Nuk eshte zone nderkufitare prandaj nuk ka ndikim nderkufitar ne mjedis. Trashegimia kulturore, fshatrat tradicionale dhe format e ndertimit .Zona ne vleresim nuk vleresohet si zone me karakteristika te vecanta arkeologjike, historike apo tradicionale

Impakti ne toke dhe ujrat nenetokesore

Punimet e ndertimit nuk do te shkaktojne prishje te regjimit te ujrave nentokesore te zones ku dhe ndodhet sheshi i ndertimit dhe ne sistemin e kullimit dhe drenazhimit. Kanalet e kullimit te zones do te lidhen me kanalet e shkarkimit te sheshit te projektit por pa nderhyrje qe do te prishe sistemin e funksionimit te tyre. Ujrat qe do te shkaktohen nga germimet ne themel do te jene te se njejtes natyre me ate te kanaleve kulluese te zone, pak me shume te ngarkuara me

llumra argjile per shkak te perberejes gjeologjike te zones. Ujrat nuk do te jene te ngarkuara nga emulsione hidrokarbure ose shkarkime te lendeve kimike te ndryshme. Ato nuk do te prishin cilesine e ujrave te kanaleve ekzistuese. Gjate ndertimit do te kemi vetem ndryshime sipërfaqesore te topografise se terrenit, nga germimet dhe zhvendosjet e dheut

Flora dhe Fauna

Sheshi dhe territori perreth ku do te zbatohet projekti nuk perben ndonje zone me ndjeshmeri dhe me status te vecante mbrojtje. Territori mbi te cilin eshte percaktuar sheshi i ndertimit do te zhvishet komplet nga shtresa e vegjetacionit, keshtu qe habitati i flares ne kete zone do te shkaterrohet. Por, pas perfundimit te punimeve te ndertimit, zona do te rehabilitohet dhe do te mbillet me bar. Projekti nuk parashikon perdorimin e substancave ose materialeve qe jane te rrezikshme ose toksike per shendetin e njerezve dhe floren e faunen, si dhe furnizimin me uje. Sidoqofte veprimtarite ndertuese qe do te shoqerojne realizimin e ketij projekti nuk do te kene ndikim te rendesishem ne mjedis. Ndikim minial pritet te kete mbi zvarraniket e zones dhe mbi shpendet.

Efektet kryesore negative

Gjate periudhes se zbatimit te projektit shfaqen keto efekte:

- a. Clirimi i pluhurave gjate germimit te themeleve te godines.
- b. Gjate kohes se kryerjes se ndertimit do te kete zhumra te cilat shkaktohen si rezultat i perdorimit te makinerive te renda dhe qe do te vazhdojne deri ne momentin e perfundimit te punimeve, te cilat afersisht mendohen te zgjasin per nje periudhe 25 mujore.
- c. Prania e grumbujve me dhe ne mjedisin e zones prish imazhin e zones perreth.
- d. Ne nivelin e ujerat nentokesor gjate germimit te tokes per hapjen e themeleve, etj.
- e. Prishja e imazhit te zones gjate periudhes se ndertimit nga prania e mjeteve te tonazhit te rende, si hapja e gropave e shume te tjera.
- f. Konsumimi i energjise elektrike.
- g. Kosumimi i materialeve te ndertimit dhe i burimeve te tjera te nevojshme per ndertimin e ketij objekti.

Efektet kryesore pozitive

- I. Investitori nje pjese te truallit do ta shfrytezoj me koeficient racional urbanistike, per ta shfrytezuar ne menyre optimale si dhe gjelberim i mjedisit perreth me koeficient te larte gjelberimi.
- II. Me ndertimin e objektit aktivizohet me tej plani i sistemimit te jashtme, ku perfshihen hapesira te gjelberuara, rruge te brendshme dhe rrjet inxhinierik dhe ndricim te jashtem.
- III. Aktiviteti i ndertimit nuk do te shkaktoje ndotje tokes, pasi nuk ka dhe as do te kete shkarkime ne mjedis te hapur dhe do te jene gjithmon nen kontroll te supervizorit te punimeve.
- IV. Ndertimi do te kete realizohet konform kushteve teknike dhe planit te menaxhimit te mjedisit(PMM).
- V. Nuk do te kete ndotje te ujerave nentokesore , pasi te gjitha ujerat e nxjera gjate germimit do te shkarkohen ne vendin perkates qe do te percaktohen nga institucionet pergjegjese.
- VI. Punesim gjate fazes se ndertimit.

Zhurmat

Nuk ka as monitorim te nivelit te zhurmave ne zonen ne vlersim, monitorimet jane kryer per disa pika te qytetit te Tiranës duke qene se ky qytet ka ne disa pika te tij trafik te renduar dhe zhvillime dinamike ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit. Ndonese kjo zone eshte me me pak trafik dhe rruge te renduara nga trafiku, eshte nje zone e prekur ndjeshem nga zhvillimet si ne fushen e ndertimit te objekteve te banimit ashtu edhe ne zhvillimin industrial e tregtar, kryesisht zona pergjate autostrades “Tirane-Durres”. Zhurmat jane nje problem i zakonshem urban dhe me problematike ne segmentet me me shume qarkullim dhe trafik te renduar.

Studimi i Gjëndjes së Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore të Shqipërisë

Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve Drin, Buna, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjose është kryer në bazë të rezultateve të parametrave fi ziko-kimike (temperatura, transparenca, pH, alkalinitet, percjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal) bërë në 18 stacione. Vlerësimi i cilësisë së ujërave të liqenit të Ohrit, Prespës dhe Shkodrës realizohet për treguesit fi ziko-kimike në 5 stacione. Monitorimi është kryer nga IEUM. Kohzgjatja e studimit Qershor-Dhjetor 2012. Analiza e rezultateve të monitorimit dhe

vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore. Në aneks do të gjeni stacionet lumore dhe liqenore, të dhënat gjeografi ke të tyre dhe kodin në rrjetin e monitorimit si dhe rezultatet mesatare të monitorimit për 2012.

Vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve dhe liqeneve dhe krahasimi i vlerave të parametrave kimike me normat përbën një nga kërkesat e në Direktivat e Bashkimit Evropian për monitorimin e gjëndjes së ujërave sipërfaqësore. Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve dhe liqeneve janë përdorur vlerat limite të përcaktuara në Direktivën e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659, për cilësinë e ujërave të ëmbla për rritjen e peshqve dhe klasifi kimi i cilësisë së ujërave të ëmbla natyrore sipas Institutit për Studimet e Ujërave të Norvegjisë .

Sipas këtij klasifi kimi, parametrat e cilësisë së ujërave të ëmbla mund të ndahen në dy grupe:

- 1) në grupin e parë bëjnë pjesë ushqyesit, lëndët organike, përbërësit acide, grimcat e ngurta dhe bakteriet e fekaleve në ujëra.
- 2) në grupin e dytë metalet e rënda në nivelet mikro në ujë, sedimente dhe peshq.

Analiza e rezultateve të monitorimit dhe vlerësimi i cilësisë së ujërave të lumenjve bëhet sipas pellgjeve lumore. Për vendmatjet lumore: temperatura, pH, alkalinitet, përcjellshmeria elektrike, Oksigjeni i tretur, NKO, NBO5, nitritet, nitratet, amoniaku, Ptotal.

Temperatura e ujit ka një shpërndarje të vlerave të tyre sipas stines dhe në përgjithësi me të njëjtën ecuri si edhe temperatura e ajrit. Prania e gazit karbonik në ujëra me alkalinitet të ulët i bën ato lehtësisht agresive. Ujrat me alkalinitet të lartë mbi 5 mg.ekuiv./L turbullohen shpejt gjatë qëndrimit të tyre në mjedis.

Lumi Ishëm:

Janë monitoruar 2 stacione : Ura e Brarit dhe Ura Salme-Shetaj. Stacionet janë vendosur në pjesën e sipërme të lumit dhe në pjesën e poshtme të tij para derdhjes në det.

Temperatura e ujit varion 25.7 – 27.10C në Urën e Brarit dhe në Salme Shetaj në Qershor dhe 16.8 - 18.4 në fazën e dytë në muajin tetor. - pH i UN varion nga 7.89 - 8.32 respektivisht per stacionet Salme Shetaj dhe Ura e Brarit. Luhatjet stinore jane te ulta ne vlerat 0.05 – 0.15. Ujrat jane neutrale, sipas Direktives Kuadër të ujit norma e lejuar për ujrat e ëmbla është (Ph = 6.5 – 8.5).

Alkaliniteti

Në këtë fazë vlerat luhaten nga 160 – 343 mol/l sipas stacioneve respektivisht Ura e Brarit dhe Salme Shetaj. - Përcjellshmëria elektrike – Luhartet në vlerat 336 - 829 $\mu\text{S}/\text{cm}$ respektivisht Ura e Brarit dhe Salme Shetaj. Luhartet stinore janë të ndjeshme rreth 100 $\mu\text{S}/\text{cm}$ nga stina në stinë. - Përmbajtja e oksigjenit të tretur në lumin Ishëm luhartet në vlerat 2.38 – 7.5 mg/l. Në fazën e dytë të monitorimit përmbajtja e oksigjenit ulet ndjeshëm në të dy stacionet. Kjo duket lehtësisht në paraqitjen grafi ke. Përmbajtja e oksigjenit të tretur në lumin Ishëm është vlera më e ulët e takuar në të gjithë lumenjtë gjatë këtij viti. Vlerat mesatare të stacioneve janë gati të njëjta 4.46 dhe 4.49.

Në vlerësimin e DKU për përmbajtjen e oksigjenit ujrave të lumit Ishëm klasifi kohen të cilësisë së keqe. Ndryshimet stinore si dhe klasifi kimi i stacioneve sipas cilësisë dallohen shumë qartë grafi kisht.

Vlerat e përmbajtjes së BOD5 luhaten nga 0.6 në 4.11 mg/l. Vlerat mesatare të secilit stacion janë 1.2 dhe 3.95 mg/l. Vlerësimi i cilësisë së ujit sipas përmbajtjes së BOD5 klasifi kohet si i gjendjes së moderuar. Paraqitja grafi ke pasqyron qartë luhartet e përmbajtjes së BOD5 gjatë monitorimit të këtij viti si dhe klasifi kimin cilësor të stacioneve : Ura e Brarit dhe Salme Shete.




Vlerat e përmbajtjes të nevojës kimike për oksigjen- NKO luhartet në 0.52 – 1.52 – 3.64 mg/l në Ura e Brarit dhe në Salme Shetaj. Në fazën e dytë përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen rritet nga 0.8 - 3.2 mg/l.

Përmbajtja e fosforit total në lumin Ishëm luhartet në vlerat 0.03 – 1.52 mg/l. Luhartet sezonale në stacionin Ura e Brarit janë të lehta ndërsa në stacionin Salme Shete luhartet janë të theksuara, gjithashtu në këtë stacion takohet dhe vlera max për vitin 2013. Përqëndrimi i fosforit është i lartë duke i tejkaluar normat dhe duke bërë që ujrave të lumit Ishëm të klasifi kohen si të cilësisë së keqe.


Amoniak është tregues i ndotjes bakteriale të ujrave. Vlerat e marra nga monitorimi i këtij viti janë nga 0 – 3.06 mg/l. Në 2 stacionet e lumit Ishëm vëmë re rritje të vlerave gjatë fazes së dytë të monitorimit. Vlerat e amoniakut në stacionin Salme Shete janë mbi norma duke bërë që ujrave të lumit Ishëm të klasifi kohen si të cilësisë së keqe, ndërsa e kundërta ndodh në stacionin Ura e Brarit ku cilësia është e nivelit mirë.

Vlerat mesatare të përmbajtjes së nitrateve luhaten nga 1.33 – 1.45 mg/l, respektivisht Ura e Brarit dhe Salme Shete. Luhartet nga periudha ujëshumtë në periudhën ujëpaktë nuk janë të mëdha. Vlerësimi i cilësisë sipas përmbajtjes së nitrateve është i nivelit mirë $\text{NO}_3 < 2 \text{ mg/l}$.

Vlerat e përmbajtjes së Nitriteve luhaten nga 0 – 0.08 – 0.45 mg/l për stacionet Ura e Brarit dhe Salme Shete. Në grafi kun e përmbajtjes së nitriteve vërehen luhatjet nga stina në stinë. Vlerat limite të përmbajtjes së nitriteve sipas DKU i përcaktojnë ujrën e lumit Ishëm si ujra me gjendje të moderuar deri të keqe NO₂ < 0.12 mg/l dhe NO₂ > 0.3 mg/l duke tentuar rejt gjendjes së varfër. Zona ku takohen përmbajtje të larta të nitriteve është stacioni Salme Shete. Lëndët Pezull - kanë luhatje në vlera nga 12.4 në 226.3 mg/l për stacionet Ura e Brarit dhe Salme Shetaj. Luhatjet sezonale janë të larta nga 113.6 – 213.9 mg/l. Vihet re një rritje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve. Vlerat e takuara të lëndëve pezull në lumen Ishëm janë më të lartat e takuara deri më tani në të gjithë lumenjtë.



Përmbajtja e NO₂ në lumin Ishëm AL 040



Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2013, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja

d) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.

Persa i perkete ndikimeve gjate fazes se funksionimit ato do te jene prezente per aq kohe sa do te perdoret edhe objekti, ose sa do te jete i banuar gjate nje viti. Gjithashtu, si faktor vleresohet edhe numri i popullsise se re ne kete objekt.

dh) Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.

Ndikimi ne mjedisin e zones nuk vleresohet ti shtrije efektet e tij ne nje distance te larget, saqe te ndikojte cilesine mjedisore te objekteve fqinje. Ky ndikim nuk eshte domethenes per natyren e perdorimit te objektit.

e) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.

Subjekti investitor, vete ose nepermjet firmes ndertuese te kontraktuar, duhet qe pas perfundimit te gjitha punimeve dhe infrastruktures perkatese, te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te lira, si ato te shtruara me beton ose pllaka, per rruget hyrese, sheshe parkimi edhe per siperfaqet e gjelberta. Duhet te mbillen peme ne perimetrin e prones per te reduktuar ndikimin ne peizazh, si dhe brenda mundesive te ruhen bimet qe i kane shpetuar demtimit nga punimet ndertimore dhe nga njolla e ndertimit te objektit.

Per objektin ne vleresim, duket qarte se mjedisi rrethues eshte sistemuar dhe nuk perben problem per erozionin apo per ndotjen e mjedisit ujore te zones, si edhe persa i perkete peizazhit, duket se eshte sistemuar.

ë) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.

Masat mbrojtese

Masa mbrojtese dhe parandaluese qe rekomandohen gjate fazes se ndertimit Kerkesat mjedisore qe synojne mbrojtjen e shendetit e te mjedisit, perfshijne specifikimin e kushteve, normave e standarteve te detyrueshme per mbrojtjen e pastertise se ajrit urban, te ujerave sipërfaqesore e nentokesore, te cilesise e vlerave te tokes, te territoreve urbane, rrugeve, trotuareve, zonave te gjelberuara

- *Rrethimi* i zones se ndertimit do te behet me llamarine ne te gjithe perimetrin e saj per te shmangur daljen e gjithfare mbeturinash inerte, per te bere nje plan organizimi sa me te mire te objektit dhe per te shmangur gjithashtu impaktin negativ qe krijojne punimet.
- *Largimi i dherave qe do te dalin gjate hapjes se theme/eve*, do te kryhet brenda nje kohe shume te shkurter nga krijimi i tyre duke mos krijuar ndotje ne ambientin perreth. Largimi i tyre te behet naten duke marre masa per te mos ndotur rruget. Kjo realizohet duke mbuluar me mushama mbeturinat qe transportohen dhe duke i lare gomate e makinave para se te dalin nga sheshi i ndertimit. Mbetjet urbane do te grumbullohen ne perfundim te objektit ne vende te caktuara nga Bashkia.
- *Rrjetat mbrojtese* per minimizimin e pluhurave dhe mbrojtjen e kalimtareve do te vendosen ne perfundim te karabinase.
- *Realizimi i infrastruktures* se brendshme rrugore do te realizohet ne perputhje me studimin urbanistik te zones perkatese duke i lene vend edhe sipërfaqes se gjelbert sipas projektit.
- *Nga sipërfaqja totale* e sheshit te ndertimit 62% e saj do te jete e zene me ndertim. Pjesa tjeter do te jete e gjitha zona funksionale qe do t'i sherbeje objektit me sip. parkimi, gjelberimi dhe rruge kryesore e dytesore.
- *Kantieri i ndertimit* do te jete i rrethuar me llamarine deri ne perfundimin e rifinitures dhe ambjenteve per rreth objektit.
- *Mbeturinat ne perfundimin e ndertimit* do te grumbullohen, transportohen dhe depozitohen ne

oraret e caktuara nga Komuna.

- *Nderhyrjet ne rrjetin e infrastruktures* do te kryhen me lejen e institucioneve perkatese sipas ligjeve ne fuqi.
- Ndertimi do te kryhet nen kontrollin e inspektoreve te mjedisit te Bashkise, per te matur ndotjet ne mjedis te cilat nuk duhet t'i kalojne parametrat e lejuar.

Masat konkrete per mbrojtjen e cilesise se ajrit

Me qellim qe shkarkimetne ajer qe emeton veprimtaria ndertuese te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara, subjektet ndertues, marrin keto masa:

- a. te perdoren mbulesa te perkoheshme dhe te lagen sipas nevojës, nje deri dy here ne dite per te reduktuar 9lirimet e pluhurave;
- b. per levizjen e materialeve ne kantier e ne sheshe ndertimi, te perdoren konvejere te mbyllur;
- c. te mirembahet sheshi i ndertimit gjate kryerjes se aktiviteteve te nivelimit, ndertimit dhe transportit;
- d. te gjitha ngarkesat te sigurohen nepermjet rregullimit, lagies ose mjete te tjera per te parandaluar derdhjet, rrjedhjet dhe pluhurat;
- e. te gjitha materialet e transportuara jashte sheshit te ndertimit te jene te lagura ne menyre te mjaftueshme ose te mbuluara mire;
- f. te gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndertimit dhe transportit te nderpriten gjate periudhave me ere te forte;
- g. te kufizohet shpejtesia e levizjes se kamioneve ne kalimet e sheshit te ndertimit, deri ne 30 km/ore;
- h. te ndalohet pergatitja dhe perpunimi i bitumeve ne temperatura te larta ne kantieret e ndertimit dhe te perdoren bitume qe kane shkalle te vogel 9lirimesh te ndotesve ne ajer;
- i. te vendosen mbulesa mbrojtese per mbeturinat e ekspozuara ndaj eres;
- j. gjate kryerjes se proceseve te rifinitures (suvatim, lysterje, veshje fasade), objekti te jete i mbuluar me rrjeta mbrojtese.

Masat konkrete per administrimin e mbetjeve te ngurta

Subjektet ndertues te godinave , rrugeve, urave, shesheve, trotua reve, administrojne mbetjet qe gjenerohen nga veprimtaria ndertuese, duke marre keto masa:

- a) mbetjet qe gjenerohen nga veprimtaria ndertimore, te sistemohen te ndara e te veqruara sipas llojit te tyre, ne vende te paracaktuara qe me pare per qendrimin e tyre provizor;
- b) mbetjet te largohen gdo dite nga sheshi i ndertimit dhe te dergohen ne vendgrumbullimet e percaktuara nga pushteti vendor;
- c) transportimi i tyre te behet ne oret me trafik te pakesuar;
- d) per transportin e materialeve dhe te mbetjeve te perdoren makina te mbulura dhe qe nuk rrjedhin;
- e) mbetjet toksike te dergohen ne nje vend depozitim te miratuar posagerisht per to;
- f) te pastrohen menjehere rrjedhjet, derdhjet, pikimet per te parandaluar ndotjen e tokes;
- g) te shtrohen me zhavorr dhe te mirembahen rruget brenda sheshit te ndertimit;
- h) sherbimet dhe riparimet e makinerive e te pajisjeve te behen sipas grafikut dhe ne vende te percaktuara per kete qellim;
- i) te lahen gomat e automjeteve para daljes nga sheshi i ndertimit.

MASAT KONKRETE PER MBROJTJEN NGA ZHURMAT

Ne cdo kantjer ose shesh ndertimi, subjektet ndertues, hartojne dhe zbatojne programin e masave per mbrojtjen nga zhurmat, i cili synon:

- a. te respektohen standardet per nivelin e zhurmave;
- b. aktivitetet e prishjes dhe te ndertimit, te kufizohen ne oret qe sjellin shqetesime per banoret perreth;
- c. aktivitetet e prishjes dhe ndertimit te programohen sipas nje grafiku ne menyre qe te evitohet operimi i disa pajisjeve e makinerive ne te njejten kohe i cili shkakton nivele te larta zhurmash;
- d. makinerite e pajisjet e fuqishme te ndertimit, si dhe ato qe gjenerojne zhurma mbi kufijt e lejuar, te jene te pajisura me ekrane mbrojtjes per zhurmat.

Vibrimi dhe zhurmat

Disa burime që do të shkaktojnë zhurmat dhe vibrimet janë të paraqitura në mënyrë të përmbledhur këtu përmendim.

- Si pasojë e punës së mjeteve të ngarkimit dhe të transportit të materialeve apo inerteve.
- Zhurmat që do të shkaktohen edhe nga makinat.

Zhurmat e krijuara nuk do të jenë të përhershme, ato janë të moderuar dhe në nivele të ulta. Ndërsa zhurmat e tjera që do të prodhohen do të vijnë kryesisht nga mjetet rrugore .

Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen ashti sic duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në zonë. Pajisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë sipas standardeve rreth zhurmës të shkaktuar në mjedis, dhe teknologjia e përdorur është shumë e avancuar bën që ky ndikim në asnjë rast të mos kalojë normat e lejuara.

Mjedis	Niveli i zhurmës-Republika e Shqipërisë			
	Efkti kritik në shëndet	LAeq (dBA)	Koha bazë (orë)	Lamax Fast (dB)
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi 70 24 110	70	24	100

Zhurma është një tingull i padëshiruar por ajo nuk akumulohet prandaj nuk ka ndikim afatgjatë. Ky percaktim mbahet si një nga aspektet kyçe të vlerësimeve të ndikimeve të zhurmës. Gjate funksionimit impakti do të bëjë vetëm mbi punonjësit dhe jo në mjedisin e banuar pasi ato ndodhen në distanca të largëta nga sheshi i ndertimit. Ndërsa vetë ndikimi është vetë afatshkurter. Oraret e transportimit të materialeve të ndertimit në rruget e daljes do të caktohen me kujdes në

menyre qe te menjanohet 9do shqetesim i trafikut lokal. Funkionimi i sheshit do te ndalohet nga ora 19.00 – 7.00, 9do dite. Ndotja nga zhurmat mund te vije nga perdorimi i makinerive ne ambientin e punes.

Ne projektin tone te marre ne studim , zhurmat do te shkaktohen kryesisht nga puna gjate fazes se ndertimit e mjeteve te renda te germimit, te transportit , te ngarkim shkarkimit. Megjithate, niveli i zhurmave te krijuara do te jete ne perputhje me udhezimin e permenduar me sipër, dhe nuk do ta kaloje kete kufi. Zhurma do te jete e perkohshme dhe nuk do te kete akumulim te saj nga receptori njeri. Paksa te ekspozura nga ketyre zhuramave do te jene punonjesit qe do te punojne ne kantjer, per te cilet do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune dhe misdis te tjerash dhe perdorimi i kufjeve. Zona e banuar ndodhet larg objektit ku do te ndertohet Disa burime qe do te shkaktojne zhurmat dhe vibrimet jane te paraqitura ne menyre te permbledhur si me poshte:

- *Si pasoje e punes se mjeteve te ngarkimit dhe te transportit te materiale apo inerteve:* Ndikime nga zhurmat do te shkaktohen nga mjetet e ndertimit sic mund te jene; vinci, buldozeri, betonier, betonierat e vegjel, eskavatore, kamionat qe transportojne materialet e ndertimit, etj.
- *Te shkaktuar gjate ndertimit te karabinase dhe gjate perfundimit te objektit:* Gjate ndertimit te karabinase do te ndikoj ne rritje te nivelit te ndotjes akustike, por ndikimi i tyre do te jete i perkohshem vetem gjate ndertimit. Do te shkaktohet zhurme dhe gjate montimit te pajisjeve te nevojshme per kete objekt.
- *Te shkaktuar nga prania e punonjesve ne kantier:* Prania e punonjesve do te kete ndikim ne rritje te nivelit te zhurmave nga bisedat e tyre sidomos gjate oreve te nates.

Ndikime në Florë dhe Fauna

- Zona në fjalë nuk pritet nga një zonë e pasur me florë dhe me faunë. Vete natyra e projektit bënë që ndikimi në florën dhe ne faunë të jëtë relativisht i ulët.

Ndikimet ne Florë

- Ndikimi në florë shkaktohet nga zënia e hapësirës duke hequr bimësinë dhe shtruar atë me cakull per vendosjen e godinave multifunkionale dhe krijimin e shesheve te punimeve dhe funksionimin e saj. Ndikimi real do të bjerë mbi dheun dhe barishtet të shtrira në këtë sipërfaqe. Masat zbutese si plani i rehabilitimit që do kryhet mbas përfundimit te projektit do mbulojë plotësishtë humbjen

ne florë në një kohë relativisht të shkurtër ku vegetacioni i zonës do të shfaqet në gjëndje më të mirë se nga ai fillestari.

Ndikimet në Fauna

- Ndikimet negative mbi faunë do të jenë të ndryshme mbi klasa të ndryshme të saj. Po ti referohemi pasurisë së zonës del se klasa që do të ndikohet është ajo e zvarranikëve por speciet që do preken janë të parëndësishme dhe nuk figurojnë ndër ato të rrezikuara apo të mbrojtura.

Masat dhe menaxhimi për parandalimin e efekteve në mjedis

- Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit është në planin e organizimit të punës, shoqëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar ndikimet negative në mjedisin përreth zonës së saj. Ne projekt është percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar në kohë. Duhet të minimizohen ndikimet në mjedis gjat fazes ndertuese duke implementuar planin e menaxhimit të mjedisit. Të gjitha punimet realizohen në përputhje me planin.

Ajri

Gjatë ndertimit

- Sperkatja me ujë për të kufizuar clirimin e pluhurave në zonat pranë materialeve të ndertimit dhe rrugeve. Pastrimi periodik i zonës, largimi i materialeve të ndryshme të dalë jashtë funksioni.

Pas ndertimit

- Hap pas hapi në zonën e shfrytezimit parashikohet sistemimi përreth. Mbjedhja me pemë e periferisë së zonës, sperkatja me ujë për të kufizuar clirimin e pluhurave gjat aktivitetit.

Trafiku

- Transportimi i materialeve që nevojiten do të programohet me kujdes për të shmangur çdo shqetesim në trafikun lokal. Do vendosen tabela orientuese për parkimin e automjeteve duke shmangur trafikun dhe aksidentet e mundëshme.

Energjia

- Menaxhim sa më eficient të energjisë elektrike, duke përdorur llamba ekonomike. Përdorimi i mekanizmave automatik për mbylljen e dyerve. Instalimi i impianteve të ngrohjes ftohjes dhe ajërimit të cilat do monitorohen vazhdimisht. Do të bëhet një menaxhim eficient i energjisë elektrike. Do të tokezohej rrjeti elektrik për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike si dhe vendosja e një rrufepritesi për këto kompleks.

Pejsazi

- Pastrimi periodik i rrugëve hyrëse të lidhura me rrugën kryesore. Në zonën përreth hap pas hapi parashikohet sistemimi dhe zhvillimi i bimësisë dekoruese. Masat estetike dhe ekologjike janë parashikuar duke krijuar kushte të përshtatshme për mbjelljen e pemëve të ndryshme lokale. Materialet e ndryshme, do të magazinohen në përputhje me kushtet teknike, duke shmangur demtime të tyre. Krijimi i kushteve të përshtatshme për mbjellje dhe kultivim të bimëve dhe pemëve të ndryshme lokale. Një pjesë e tokës së germuar do të përdoret për të rregulluar relievin e zonës për një pamje sa më natyrore.

Erozioni

- Minimizimi i erozionit është një detyrë primare gjatë fazës së projektit. Bëhet monitorimi i të gjitha germimeve nga ekspertet përkatëse për të siguruar masat që duhen marrë për të shmangur sa më shumë erozionin e tokës. Është projektuar një sistem kullimi i ujërave të shiut që vijnë nga sipërfaqet e kantierit të ndërtimit dhe çatitë e godinave.

Mbetjet e ngurta dhe urbane

- Monitorimi gjatë funksionimit, lidhur me pastrimin ka si synim që të evitohet prerja e druveve gjatë përgatitjes së sheshit dhe fazës së funksionimit. Hedhja e materialeve të nxjerra nga përgatitja e sheshit të ndërtimit kërkon mbajtjen e shënimeve përkatëse në regjistrimin e punimeve të kryera. Për këto qëllime duhet të bëhet dokumentimi i materialeve të ngurta të parrezikshme që hidhen në vendet e paracaktuara. Dërgimi i materialeve të ndërtimit dhe i pajisjeve në shesh ben

te nevojshem inspektimin e perhershem, i cili duhet te realizohet ne lidhje me kontrollin e emetimeve te pluhurit ne atmosfere gjate transportit te dheut.

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit

Shkarkime ne uje

- Nuk kemi ndotje te ujerave nentokesore. Ujerat qe dalin nga aktiviteti i human ne objekt jane ujera urbane te cilat jane menaxhuar nepermjet sistemit te kanalizimeve te zones. Gjithashtu mund te kete edhe ujera te larjes se ambjenteve perreth objektit, por qe nuk vleresohen me perberje te elementeve ndotes per mjedisin. Nepermjet NJ.Q.V, subjekti ka plotesuar kriteret e lidhjes se sistemit te kanalizimeve. NJ.Q.V duhet te kete projektuar mire menaxhimin e sistemit te kanalizimeve dhe te furnizimit me uje te pjshem per situaten e re, e cila ka njohur nje zhvillim dinamik e te rendesishem vitet e fundit. Objekti ndodhet ne nje zone me studim urbanistik te miratuar dhe qe parashikon zhvillime mikse per zone industriale.

f) Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille).

Subjekti investitor, vete ose nepermjet firmes ndertuese te kontraktuar, duhet qe pas perfundimit te gjitha punimeve dhe infrastruktures perkatese, te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te lira, si ato te shtruara me beton ose pllaka, per rruget hyrese, sheshe parkimi edhe per siperfaqet e gjelberta. Duhet te mbillen peme ne perimetrin e prones per te reduktuar ndikimin ne peizazh, si dhe brenda mundesive te ruhen bimet qe i kane shpetuar demtimit nga punimet ndertimore dhe nga njolla e ndertimit te objektit.

Per objektin ne vleresim, duket qarte se mjedisi rrethues eshte sistemuar dhe nuk perben problem per erozionin apo per ndotjen e mjedisit ujore te zones, si edhe persa i perkete peizazhit, duket se eshte sistemuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
 Ministria e Ekonomisë,
 Tregëtisë dhe Energjetikës

LICENCE



01-00043-06-2009
 Kodi: 14.2.4.13.421
 Data e lëshimit: 11/06/2009
 Aditi i vlefshmërisë: Pa afat

STUDIODHOMORJE
 AUDITIMPT. EKONOMICIT

Kategoria:
 Shërbime ekspertise dhe/ora profesionale tëbhuve në ndihmën në qyrtidh

Non-aspjegjorja:
 Vepërtidhja e ekspertidhve tëbhuve në ndihmën në qyrtidh

Vepërtidhja specifidhe:
 1. Ndihmë në qyrtidh
 2. Auditim qyrtidh

Iskualifikimet:

Emërtidhja parashikuar / veprimtaridhja:
 Hartidhja / raportidhe për VM, auditim, ekspertise mjedidhore

Kodi i qyrtidh:

Kufidhja specifidhe:
 Licencidhja gjithidhjet lidhur auditime në regjistronet në fildh

Qyrtidhja specifidhe:
 Licencidhja aktivitetit sipas dequmendit në regjistronet në fildh

Vendndhja / kryeridhja të veprimtaridhve:
 Aktivitetidhja ushtidhjet në të gjithë Republikën e Shqipërisë

Qyrtidhja: TIRANE, Shërbidhe TIRANE, B/P: TIRANE, Q/P: TIRANE
 Adresadhoqyrtidhja: "Voznesinidhja", n.51, blloku 5

Qyrtidhja: TIRANE, Shërbidhe TIRANE, B/P: TIRANE, Q/P: TIRANE
 Adresadhoqyrtidhja: "Zogu F", pallati i punës TIRANE Shërbidhe

Mënyrdhjetidhja / sportidhja:



VERTETIM

Vertetaj sot me date 18.05.2015 une notere Gentiana Shkodra, me studio ne Tirane, ne adresen e sipertreguar, anetare e Dhomes se Noterise Tirane,

Se akti bashkëngjitur:

License STUDIOPROJEKT Nipt K620210018

ESHTE NJE KOPIJE E NJEJTE ME AKTIN ORIGINAL

Leshohet me kerkesen e Znj.Helena Merka

Sa me lart garantohet me firmen dhe vulen time zyrtare. Vertetimi leshohet ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" dhe Udhhezimit te Ministrise se Drejtësisë n. 6291 date 17.08.2005, pika 3,4,7.


Gentiana SHKODRA
NOTERE

PULLE TAKSE

100

SHQIPERISE

100

SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100

SHQIPERISE

100

SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100

SHQIPERISE

100

SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100

SHQIPERISE

100

SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100

SHQIPERISE

100

SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100

SHQIPERISE

100

SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100

SHQIPERISE

100

SHQIPERISE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 351 Prof.

Tirane, me 09.09. 2004

Vendimi Nr.11, Nr.086Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Xhevaër DERMYSHI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUGA



VERTETIM

Vertetoj sot me date 18.05.2015 une notere Gentiana Shkodra, me studio ne Tirane, ne adresen e sipertreguar, anetare e Dhomes se Noterise Tirane,

Se akti bashkengjitur:

Certifikate nr.331 prot per Z.Xhevahir Dermysli

ESITTE NJE KOPJE E NJEFTE ME AKTIN ORIGINAL

Leshohet me kerkesen e Znj.Helena Metka

Sa me lart garantohet me firmen dhe vulen time zyrtare. Vertetimi leshohet ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" dhe Udhezimit te Ministrise se Drejtesise n. 6291 date 17.08.2005, pika 3,4,7.


Gentiana SHKODRA
NOTER

